

VENDIM
Nr.2, datë 20.10.2006

**PËR SKEMËN EKZISTUESE PËR HUANË E BUTË QË JEPET PËR MAKINERITË
BUJQËSORE DHE PËR LINJAT E AGROPËRPUNIMIT**

Komisioni i Ndihmës Shtetërore, në mbledhjen e tij të datës 20.10.2006, shqyrtoi raportin “Për skemën ekzistuese për huanë e butë që jepet për makineritë bujqësore dhe për linjat e agropërpunimit”. Raportimi është bërë pranë Drejtorisë së Ndihmës Shtetërore në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës nga Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit me shkresën nr.2029, datë 24.7.2006 dhe është regjistruar në regjistrin e DNSH-së me nr.AI/011/2005.

Komisioni i Ndihmës Shtetërore, mbështetur në nenin 2 shkronja 2 të ligjit nr.9374, datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore”,

VENDOSI:

Skema e dhënë nuk bie në fushën e zbatimit të ligjit nr.9374, datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore”.

Në kuadër të detyrimeve të MSA-së dhe Marrëveshjes së OBT-së, Komisioni i Ndihmës Shtetërore

REKOMANDON:

1. Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit duhet të bëjë një klasifikim të saktë të subjekteve përfituese mbi bazën e nënsektorëve të veçantë.

2. Llogaritja e intensitetit të skemës të bëhet duke zbatuar kriterin e kontributit edhe nga ana e përfituesit të ndihmës. Duhet të ketë një diferencim midis rajoneve të ndryshme të vendit dhe, për të nxitur investimet në zonat e thella malore, tek ato mund të aplikohet intensitet më i lartë i ndihmës.

3. Vlera maksimale e totalit të skemës, për secilin nga nënsektorët, nuk duhet të kalojë në asnjë rast kufirin prej 5% të përcaktuar në Marrëveshjen e OBT-së.

4. Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit duhet të marrë parasysh vlerën përshtuese (të akumuluar) të të gjitha skemave të ndihmës që jepen në sektorët e bujqësisë, pasi kufiri prej 5% përfshin të gjitha format e ndihmës për këta sektorë.

KRYETARI
Genc Ruli